



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2023:236135
Datë: 23.05.2024
Numri i dokumentit: 05725595

K.DH.SH.II.nr.609/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Ramush Bardiqi, ne çështjen juridike përmbartimore të kreditorit “Cooperation Architecture” shpk, me seli ne rr. “Adem Gllavica” nr.137 ne Prishtinë, kundër debitorit “Viva Fresh” shpk, me seli ne fshatin Suhadoll Magjistranja Prishtinë - Lipjan ne Graçanicë, shpk, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, ushtruar përmes përfaqësuesit te autorizuar avokat Agnez Fura, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës-Dhomat e Shkallës se Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.2458/2022 dt.31.10.2023, me datën 22.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit “Viva Fresh” shpk, me seli ne fshatin Suhadoll Magjistranja Prishtinë - Lipjan ne Graçanicë, ” shpk, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës-Dhomat e Shkallës se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.2458/2022 dt.31.10.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkallës se Parë -Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr. 2458/2022 dt.31.10.2023, e ka refuzuar ne tërësi si te pabazuar prapësimin e debitorit “Viva Fresh” shpk, me seli ne fshatin Suhadoll Magjistranja Prishtinë - Lipjan ne Graçanicë, shpk ndërsa ka lënë ne fuqi urdhrin përmbartimor P.nr.161/2022 dt.03.11.2022, te lejuar nga Përmbartuesja Private Emnine Sherifi Lubeniqi me seli ne Prishtinë, ndërsa ka detyruar debitorin qe brenda afatit prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktvendimi t’ia paguaj kreditorit shpenzimet e procedurës ne shumen prej 208 euro për përpilimin te përgjigjes ne prapësim.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak te shkeljes esenciale te dispozitave te procedurës, vërtetimit te gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike dhe zbatimit te gabuar te se drejtës materiale, me propozim qe gjykata e shkalles e dytë ta aprovoj

ne tërësi si te bazuar ankesën e debitorit dhe aktvendimin e atakuar ta anuloj ashtu qe çështjen ta kthej ne rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje ne ankesën e debitorit ka ushtruar kreditori me arsyetimin se pretendimet e debitorit janë te pabazuara dhe kundërthënëse, propozon qe gjykata e shkalles se dytë ta refuzoj ankesën debitorit dhe aktvendimin e atakuar ta vërtetoj.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Cooperation Architecture” shpk, me seli ne rr. “Adem Gllavica” nr.137 ne Prishtinë, më datën 03.11.2022, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit “Viva Fresh” shpk, me seli ne fshatin Suhadoll Magjistralja Prishtinë - Lipjan ne Graçanicë” shpk, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturës me nr.01-04-2021 dt.01.04.2021. Përmbartuesja Private Emine Sherifi-Lubeniqi me seli ne Prishtinë, sipas propozimit te kreditorit, me urdhrin përmbartimor P.nr.161/2022 dt.03.11.2022, ka lejuar përmbartimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër te borxhit nga fatura t’i paguaj shumën prej 11,833.20 euro, me kamatë prej 8% ne vit nga data e arritjes për pagesë te faturës si dhe shpenzimet e përpilimit te propozimit për përmbartim ne shumen prej 208 euro.

Kundër urdhrin përmbartimor debitori ka paraqitur prapësim me datë 11.11.2022, duke deklaruar se fatura e ofruar nga kreditori është e pavulosur dhe e panëshkruar, ashtu qe nuk është e përshtatshme për përmbartim, debitori shton se një pjesë nga detyrimi i kërkuar nga kreditori veç se e ka paguar gjë qe dëshmohet përmes transaksioneve bankare, propozon qe gjykata ta aprovoj ne tërësi si te bazuar prapësimin e debitorit dhe urdhrin përmbartimor ta anuloj.

Përgjigje ndaj prapësimit te debitorit ka ushtruar kreditori me datën 15.11.2022, me arsyetimin se prapësimi i debitorit nuk mund te jetë objekt shqyrtimi dhe vlerësimi, është e pakontestueshme se debitori ndaj kreditorit ka detyrim edhe shumen prej 11,833.20 euro sepse një pjesë te detyrimit debitori e ka paguar dhe atë me datën 28.05.2021 ne shumen prej 10,000 euro dhe me datë 01.09.2021 shumen prej 5,000 euro. Propozon qe gjykata ta refuzoj prapësimin e debitorit si te pabazuar ndërsa urdhri përmbartimor te mbetet ne fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkalles se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.2458/2022 dt.31.10.2023 me të cilin e ka vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Ka arsyetuar se fatura mbi bazën e te cilës është lejuar përmbartimi përmban te dhënat tjera te nevojshme por jo edhe kohen e përmbushjes se detyrimit monetar,

mirëpo megjithatë kreditori se bashku me propozimin për përmbarim ka paraqitur deklaratë për arritshmërinë e kërkesës sipas nenit 30 te LPP duke përcaktuar se kërkesa është bere e arritshme 30 dite nga data e pranimit te saj. Gjykata konsideron se fatura është pranuar nga debitori pasi e njëjta është përmbushur pjesërisht nga i njëjti sepse me datën 28.05.2021 debitori e kishte kryer pagesën ne shumën prej 10,000 euro ndërsa me datën 01.09.2021 e kishte kryer pagesën ne shumen prej 5,000 euro ne emër te faturës lëndore dhe këtë kreditorit e ka deklaruar ndërsa debitorit e ka pohuar se këto pagesa janë bere ne emër te faturës lëndore, dhe me këtë debitori ka mbetur ne detyrime edhe për shumen prej 11,833.20 euro ndaj kreditorit. Gjykata i referohet edhe nenit 29 par.1 dhe 3 te LPP si dhe nenit 30 te LPP, nga rrjedh se ne rastin konkret fatura përmban te gjitha elementet e kërkuara nga dispozitat ligjore si me larte sepse momenti i përmbushjes e detyrimit monetar është përcaktuar përmes deklaratës se arritshmërisë e paraparë me nenin 30 te LPP. Gjykata po ashtu i është referuar nenit 71, 69 par.4, nenit 73 ndërsa ne lidhje me shpenzimet e procedurës vendosi konform nenit 452 par.1 dhe 463 par.1 dhe 2 te LPK, duke vendosur kështu si ne dispozitiv te aktvendimit te saj.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore me rastin e vendosjes, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikim në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarimi është lejuar në bazë të faturës nr.01-04-2021 dt.01.04.2021 te lëshuar nga kreditori, e cila sipas provave ne lende përkatësisht transaksioneve bankare 28.05.2021 debitori kishte paguar shumën prej 10,000 euro ndërsa me datën 01.09.2021 debitori kishte paguar shumen prej 5,000 euro. Edhe kjo gjykatë pranon përfundimin juridik te gjykatës e shkalles se parë se fatura mbi bazën e te cilës është lejuar përmbarimi përmbush kushtet ligjore te parapara me nenin 29 par.3 te LPP sepse e njëjta konsiderohet se përmban te gjitha elementet për te qenë dokument i besueshëm dhe si e tillë te jetë edhe e përshtatshme për ekzekutim, e kjo mbështetur ne faktin se kreditori ka vepruar konform nenit 30 te LPP sepse me datën 03.11.2022 ka parashtruar deklaratë me shkrim duke bere te ditur se kërkesa e tij është bërë e arritshme me datën e faturës 01.04.2021 gjegjësisht 30 ditë nga dita e pranimit te saj, andaj duke marrë për bazë se përmes emailit te dt.14.04.2021 rezulton se fatura është pranuar nga debitori si dhe faktin se debitori ka paguar një pjesë te detyrimit te tij ndaj kreditori edhe kjo gjykatë vlerëson se debitori ka pranuar faturën e njëkohësisht edhe detyrimin tij qe rrjedh nga kjo faturë ndërsa ne shkresa te lendes nuk rezulton se debitori konteston faktin se pagesat nuk janë bere ne emër te faturës mbi te cilën është lejuar përmbarimi.

Gjykata e shkalles se dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj te bazuar në dispozita ligjore, ashtu qe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e shkalles se dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK dhe ne konstatim te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e shkalles se dytë analizoi edhe pretendimet e debitorit se fatura mbi bazën e te cilës është lejuar përmbarimi nuk paraqet dokument te besueshëm dhe nuk është e përshtatshme për përmbarim konform nenit 27 te LPP, por ky pretendim nuk qëndron sepse se pari fatura nuk është dokument përmbarimor, si edhe pretendimet tjera te debitorit por i vlerësoi si te paargumentuara ashtu siç parasheh neni 69 par.4 i LPP andaj te njëjtat i refuzoi si te pabazuara ndërsa aktvendimin e atakuar e vërtetoi.

Kompetenca e Dhomës se Shkalles se Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhomat e Shkalles se Dytë
K.DH.SH.II nr.609/24, me datë 22.05.2024

Gjyqtari,
Ramush Bardiqi